

UDHËZIM
Nr. 41, datë 12.10.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 2.8.2013 “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E
MEDALJES SË ARTË”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pika 1 e udhëzimit nr. 21, datë 2.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënie të medaljes së artë, të ndryshojë si më poshtë:

“1. Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet “Medalje e artë” nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në MAS.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla